

# SISTEMI I RI I ARSIMIT NË TOSKAN

## Te rejat e reforma

Në vitet e fundit janë bërë ndryshime të rëndësishme në sistemin shkollor e formativ.


Ligji Kombëtar 296/2006 ka bërë që arsmi i detyrueshëm të jetë të paktën 10 vjet.

Në veçanti, në Toscana arsimit i detyruar mund të shlyet vetëm brenda sistemit shkollor me një frekuencë prej 10 vjet shkollë (8 vjet shkolla tetëvjeçare+2 shkolla e mesme).

Pas shkollës tetëvjeçare duhet vazhduar për të gjithë me detyrim shkolla e mesme.

Qëllimi është rritja e njohurive dhe aftësive gjatë ketyre dy viteve e për tu ndihmuar të vendosni se dëshironi që :

- Të vazhdoni shkollën dhe të merrni një diplomë ose kualifikim profesional të paktën që jepet mbas mbarimit të vitit të tretë nëse jeni të regjistruar në një shkollë profesionale
- Të marrësh pjesë në një Kurs 2 vjeçare në të cilën në fund të saj keni një diplomë të nivelit të dyte europiane
- Për kë ka vendosur mos të vazhdojë shkollën e donë të kërkoj punë si me kontrat nxënës puntor(apprendistato)për të çlyer të drejtat-detyrat kundrejt arsimit të detyrueshëm.





## Reforma e liceve (gjimnazeve) dhe riorganizimi i institutëve teknike dhe profesionale

Viti shkollor 2010 -11 ka parë vënien në zbatim të reformës së shkollave të mesme.

Elementet dallues të reformës janë:

- riorganizimin dhe reduktimin e degëve të studimit
- orare të reduktuar (më pak orë mësimi javore, orë me 60 minuta e rishikimin e orëve për lëndë mësimi).

### LICEU (shkolla e përgjithshme)

Reformës parashikon 6 degë liceu (shkolla e përgjithshme):

- Liceu artistike, (është i ndarë në tre degë: artet vizuale - arkitekturë, desing, mjedis - audiovizual, multimedia, skenografia)
- Liceu (shkolla e përgjithshme) klasik (me reformën është futur mësimi i një gjuhe të huaj gjatë gjithë 5 viteve të shkollës)
- Liceu (shkolla e përgjithshme) shkencor (me një opsion shkencor e teknologjik që do të lejojë thellimin e njohurive të teorive shkencore dhe proceset teknologjike)
- Lice (shkolla e përgjithshme) gjuhësor (Studimi i 3 gjuhëve të huaja )
- Lice (shkolla e përgjithshme) muzikor dhe valle (e ndarë në dy seksione të muzikës dhe valle)
- Lice (shkolla e përgjithshme) shkencave humane (zëvendëson soçiopsikopedagogjiko duke sjell në regjim eksperimentacionin që kishin filluar në vitet e shkuara. Shkollat mund të aktivojnë degën ekonomiko-sociale)

### ISTITUTET TEKNIKE TE REJA

Riorganizimin e arsimit teknik është i ndarë në 2 sektor dhe 11 degë

Në sektorin e ekonomis në momentin që popublikojmë këtë udhëzues janë shtuar 2 degë

- administrativ, financa dhe marketing
- turizmi.

Në sektorin e teknologjisë janë përcaktuar 9 degë

- mekanike, mekatronika dhe energjia
- transport dhe Logjistika
- elektronika dhe elektroteknika
- informatika dhe telekomunikacioni
- grafika dhe komunikimi
- kimi, materiale dhe bioteknologjia
- sistemi i modës
- agraria dhe agroindustria
- ndërtimi, mjedisi dhe territori.

### ISTITUTET E REJA PROFESIONALE

Me riorganizimin e shkollave profesionale janë parashikuar 2 degë

Istitutet profesionale të shërbimeve me këto degë:

- Shërbimet për Bujqësin dhe Zhvillim Rural
- Shërbimet për mirëmbajtje dhe asistencë teknike
- Shëndetësi dhe Shërbime Sociale
- Shërbimet për ushqimet, verën dhe mikpritje në hotel
- Shërbime komerciale.

Istituti profesional i industrisë dhe artizanatit:

- prodhime e artizanale dhe industriale

Sistemi i shkollave profesionale është i ndarë në këto faza në dy 2 vjeçare dhe 1 viti i pestë(dy vjeçari i dytë është i ndarë në vite singël për të ndihmuar kalimin nga sisteme të ndryshme arsione e formative)

Mbas mbarimit të vitit të 5°studenti jep provimet e pjekuris e mer diplomën e shkollës së mesme,e cila është e dobishme edhe për të ndjekur studimet në çfardolloj univeraiteti.

### **Sistemi rajonal i ofertes ndihmese integruese**

Nga viti shkollor 2011-2012 studentet e rregjistruar ne vitin e pare te pesevjecarit te Istituteve Profesionale dhe studentet e rregjistruar ne vitin e dyte te degeve ne zevendesim mund te marrin ne fund te vitit te trete edhe titullin e kualifikimit profesional.

Deget formuese kane kohezgjatje trevjecare, per nje total prej 1800 oresh. Kualifikimet qe mund te ndiqen jane te permbledhura ne Repertorin Rajonal te figurave profesionale ne lidhje me figurat kombetare te referimit. Cdo institut kerkon aktivimin e drejtimit IIEFP koerent me oferten formuese te aktivuar per ndjekjen e diplomes. Per informacion mbi oferten formuese keshillojme te informoheni direkt prane personave referues te orientimit ose prane sekretarise studenti.

### **Nderhyrja provinciale e formacionit për brak tisje**

Per të rinjtë që kanë lënë përfundimisht shkollën ijepet mundësia per të vazhduar cursin 2 vjecar në të cilën do tju jepet një diplom e nivelit të dytë.

Për tu regjistruar në këtë kurs duhet të keni 16 vjec, të keni mbaruar shkollën 8-vjecare dhe të keni të paktën 10 vite shkollore.

Duhet të shkoni në qendrën e punësimit ku juve keni rezidencën dhe tju drejtoheni një tutori që tju informoj rreth kursit të financuar dhe për të mbësmtetur identifikim e asaij që i për gjigjet interesave dhe karakteristikave të djalit.

Për vitin 2012-2013 qarkut empolesë Valdelsa do të aktivizohen rrugë për arritjen e kualifikimeve të mëposhtme:

Operator të mirëqenies (parukier uniseks dhe estetist)

Operator për shërbimet e shitjes

Operator për riparimin e automjeteve me motor

Operator për impiantet termo idraulike

Operator teknik

Operator marangoz